



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 71 Datë 24.12.2021

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT TE VITIT 2022

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54/dh, 55/3, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” nenet 6,10,22,28,40,41, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), nenet 6,15,44, ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,(i ndryshuar), Ligjin nr.115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin e Ministrise se Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, (i ndryshuar) pikat 94,96,100,113,120,122, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Udhëzimin Nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024” Udhëzimin Plotësues Nr.20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”, Shkresës Nr.18976 prot datë 29.10.2021 “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2022”,

VENDOSI

1. Të miratojë Buxhetin e Bashkisë Kukës për vitin 2022, si më poshtë:

- a) Parashikimin e të ardhurave për vitin 2022, në vlerën totale **1,409,268** (një milion e katërqind e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) në **mijë lekë**, sipas tabelës **Nr.1**, bashkëngjitur këtij vendimi.
- b) Shpërndarjen e burimeve financiare për vitin 2022, në vlerën totale **1,409,268** (një milion e katërqind e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) në **mijë lekë**, sipas tabelës **Nr.2**, bashkëngjitur këtij vendimi.

- c) Tavanet e shpenzimeve sipas programeve për vitin 2022, në vlerën totale **1,409,268** (një milion e katërqind e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) në **mijë lekë**, sipas **tabelës Nr.3**, bashkëngjitur këtij vendimi.
- d) Planin e investimeve kapitale për vitin 2022, në vlerën totale **97,144** (nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e dyzet e katër) në **mijë lekë**, sipas **tabelës Nr.4**, bashkëngjitur këtij vendimi.
- e) Numri i punonjësve, struktura dhe niveli i pagave për vitin 2022, sipas **tabelës Nr.5**, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETARI I KËSHILLIT

ANILDA BIBA

